

ELEMENTE TË TERMINOLOGJISË LITURGJIKE NË VEPRAT E LETËRSISË SË VJETËR SHQIPE

Evalda Paci

Instituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë, QSA, Tiranë. Emaili: evaldapaci@yahoo.com

Abstract

Kumtesa do të përqendrohet në trajtimin e disa aspekteve të terminologjisë liturgjike, e inicuar në gjuhën tonë pikërisht me veprat që i përkasin një periudhe të rëndësishme të historisë së letërsisë së shkruar shqiptare. Leksiku i liturgjisë gjurmohet në autorët kryesorë të kësaj letërsie të iniciuar me librin e parë të njohur gjer më sot nga tradita e studimeve albanologjike: Mesharin e Gjon Buzukut(1555).Që nga ky autor e këtij tradita shkrimore por dhe terminologjia përkatëse e diktuar nga vetë tematika e veprave pasuese merr një profil përherë më të përvijuar e të konsoliduar, me prurje që dhe sot e kësaj dite ekzistojnë në terminologjinë aktuale. Emërtimet e perëndisë, e objekteve të kultit, e koncepteve themelore të liturgjisë, leksiku parakristian, nënsistemet gjuhësore që përfshihen do të bëhen objekt trajtimi duke pasur parasysh përdorime jo vetëm nga libri i Gjon Buzukut por dhe nga shqipërimet e Budit(1618-1621), leksiku i Frano Bardhit(1635), vepra e Pjetër Bogdanit(1685) dhe e autorëve të tjerë pasues.Një trajtesë e tillë ka synimin t’i shërbejë jo vetëm historisë së gjuhës së shkruar si disiplinë, por dhe studimeve diakronike në fushë të leksikut dhe regjistrave gjuhësorë më të specializuar.